

FTESË
Konventa për Integrimin Europian
Grupi i Punës I (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore)

Sesioni 1, Tema: Ndhimja ligjore falas në Shqipëri – roli dhe kontributi i aktorëve jo shtetërorë

E hënë, 16 nëntor 2020, 10:30-12:00

Format hibrid: Tirana International Hotel (paneli)

dhe Online Zoom Platform

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) dhe Ministria e Drejtësisë (MD) në partneritet me Slovak Foreign Policy Association, me mbështetjen financiare të SlovakAid, kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në Sesionin 1 të Grupit të Punës I me temë “Ndhimja ligjore falas në Shqipëri – roli dhe kontributi i aktorëve jo shtetërorë”.

Me qëllim krijimin e urës së bashkëpunimit mes institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile e njëkohësisht forcimin e kapaciteteve në të dy sektorët, rikthehet Konventa për Integrimin Europian 2019-2021, zbatuar nga Lëvizja Europiane në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e linjës, pas zhvillimit të suksesshëm të saj në periudhën 2014-2016. **Konventa për Integrimin Europian** përfaqëson një iniciativë që ka si qëllim të institucionalizojë debatin publik lidhur me çështjet e Bashkimit Europian, bazuar në partneritetin mes qeverisë dhe institucioneve publike, shoqërisë civile si dhe organizatave të biznesit; të forcojë aftësitë e ekspertëve në negociatat lidhur me Integrimin Europian; si dhe të transferojë eksperiencën sllovaqe në fushën e ndërtimit të institucioneve demokratike dhe dialogut të përhershëm profesional. Fillimisht, ky model unik është aplikuar dhe zhvilluar me sukses nga Slovak Foreign Policy Association gjatë vitit 2003-2007 e më pas zbatuar në Serbi, B&H, Mal të Zi, Maqedoni e Veriut. Në kuadër të Konventës në Shqipëri, janë ngritur Grupe Pune sipas kapitujve të negociatave me BE: (GP I: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore (Kapitulli 23); GP II: Drejtësia, Liria, Siguria (Kapitulli 24); GP III: Bujqësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit (Kapitulli 11&12); GP IV: Fondet Strukturore (Kapitulli 22).

Grupi i Punës I, falë përvojës së ekspertëve, do të shqyrtojë e do të diskutojë tema në fushën e sistemit gjyqësor, drejtësisë dhe të drejtave të njeriut duke parashikuar një proces të mëtejshëm të reformës dhe pranimit në BE. Brenda Kapitullit 23, kryesisht janë diskutuar anti-korrupsioni, të drejtat e fëmijëve, shërbimi ligjor falas dhe informimi, reformat në sistemin e drejtësisë etj. të cilat më tej do të reflektojnë në zgjedhjen e temave të tjera të mundshme. Në këtë Grup Pune do të organizohen katër Sesione. Këto sesione janë planifikuar të bashkë-kryesohen nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe ekspertë të brendshëm të Konventës. Çdo sesion synon të mbledhë përfaqësues nga Institucionet Shtetërore, Organizatat Ndërkombëtare, OJQ-të, firmat e avokatisë, ekspertë ligjorë dhe academia që përqendrohen në temat që lidhen me Kapitullin 23 të Acquis të BE-së.

Në **sesionin 1** të Grupit të I të Punës është përzgjedhur për diskutim ndihma ligjore në Shqipëri, sfidat në këtë fushë dhe nevoja për bashkëpunim mes aktorëve shtetërore dhe atyre jo-shtetërorë në këtë fushë. Ky sesion synon të nxjerrë rekomandime dhe sugjerime në lidhje me temën e përzgjedhur dhe çështje që lidhen me kornizën ligjore; kapacitetin institucional dhe trajtimin e çështjeve.

Aktiviteti do të zhvillohet në formatin hibrid: **në sallë** (paneli vetëm) dhe **online**. Ju lutem konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në e-mailin: info@em-al.org për tu pranuar **në aktivitet**. Aktiviteti do të ketë përkthim të **njëkohshëm shqip -anglisht**.

PROGRAMI

Grupi i Punës I (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore)

Sesioni 1, Tema: Ndhimja ligjore falas në Shqipëri – roli dhe kontributi i aktorëve jo shtetërorë

E hënë, 16 nëntor 2020, 10:30-12:00

Format hibrid: Tirana International Hotel (Paneli)

dhe Online ZOOM Platform

Link: <https://us02web.zoom.us/j/88266944740?pwd=Q3N4UjJoTDBmdUVNVjNwY3pNbmg5dz09>

Meeting ID: 882 6694 4740

Passcode: **Emaconv**

10:00 - 10:30 Regjistrimi i pjesëmarrësve online

Tematikat:

- Kuadri ligjor dhe institucional i ndihmës ligjore falas në Shqipëri
- Sfidat kryesore: transparencja, aksesimi në drejtësi, informimi, trajnimi dhe kapacitetet e ofruesve të shërbimit, monitorimi dhe cilësia e shërbimit, kapacitetet financiare – rekomandime nga eksperiencat sllovaqe
- Përfshirja e shoqërisë civile në shërbimin e ndihmës ligjore falas- eksperiencat më të mira nga Shqipëria dhe Sllovakia
- Promovimi dhe informimi i grupeve të interesit

10:30 - 10:40 Fjalimet Hyrëse

Znj. Adea Pirdeni, Zëvendës-Ministre e Drejtësisë në Shqipëri

Z. Gledis Gjipali, Drejtor Ekzekutiv i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Ndhimja ligjore falas – sfidat në Shqipëri dhe bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm – rekomandime nga eksperiencat sllovaqe

10:40 - 10:50 Znj. Patricia Pogaçe, Drejtorja e Ndhimës juridike falas, Ministria e Drejtësisë

10:50-11:20 Eksperiencat sllovaqe për ndihmën ligjore falas - praktikat më të mira dhe rekomandime –

Znj. Eva Kovacechova, Avokate, Ish Drejtore e Qendrës së Ndhimës Ligjore në Sllovakia

11:20– 11:40 Diskutim i hapur me grupet e interesit

- Përfaqësues të OJF të autorizuar nga MD për ofrimin e ndihmës ligjore falas
- Përfaqësues nga Klinikat e Ligjit pranë Universiteteve
- Përfaqësues nga firmat ligjore apo avokatë

11:40– 11:50 Moderatore dhe përmbledhje e përfundimeve dhe rekomandimeve

Znj. Evis Fico, Këshilltare e Ministrit, Ministria e Drejtësisë